



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 tetor 2020
Nr.ref.:RK 1630/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI15/19

Parashtrues

Shemsi Ferizi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Themelore në
Prishtinë NJN. Nr. 157/2017, i 13 prillit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shemsi Ferizi (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Mustafë Musa, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë NJN. Nr. 157/2017, të 13 prillit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe nenin 2 të Protokollit Nr. 7 (E drejta e apelit në çështjet penale) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të neneve 8 dhe 11 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 janar 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 26 shkurt 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta dorëzon autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës në Gjykatë.
8. Më 8 mars 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi një dokument të titulluar “kërkesë për azhurnimin e lëndës” me ç’ rast kërkoi nga Gjykata që “në afat sa më të shkurtër të vendoset për rishikimin e procedurës penale”.
9. Më 29 mars 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin e lartpërmendur në Gjykatë.

10. Më 19 prill 2019, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prishtinë.
11. Më 23 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi shkresa në vëllim prej 131 faqesh që ndërlidhen me procedurat e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjen penale të rastit në fjalë. Gjykata Themelore në Prishtinë po ashtu dorëzoi përgjigje nga aspekti procedural dhe material ndaj pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës nr. KI15/19.
12. Më 14 gusht 2019, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë dëshminë (fletë-kthesën) që vërteton datën e pranimi të vendimit të kontestuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
13. Të njëjtën datë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë dëshminë (fletë-kthesën) që vërteton datën e pranimi nga parashtruesi i kërkesës të vendimit të kontestuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
14. Më 30 gusht 2019, një kopje e kërkesës iu dërgua Ministrisë së Drejtësisë, nga e cila, po ashtu u kërkua që të dorëzojë dëshminë (fletë-kthesën) që vërteton datën e pranimi nga parashtruesi i kërkesës të vendimit të kontestuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
15. Më 22 dhe 30 gusht 2019 dhe 5 shtator 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Ministria e Drejtësisë dhe përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzuan përgjigjet e tyre lidhur me kërkesën nr. KI15/19.
16. Përgjigjet e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ministrisë së Drejtësisë dhe përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës janë reflektuar në tekstin e mëposhtëm tek vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës.
17. Më 5 shkurt 2020, Gjykata vendosi që kërkesa nr. KI15/19 të shqyrtohet në një datë tjetër për shkak të plotësimit të raportit të Gjyqtarës raportuese me të dhëna plotësuese.
18. Më 15 maj 2020, Gjykata përsëri kërkoi nga Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojnë dëshminë (fletë-kthesën) që vërteton datën e pranimi nga parashtruesi i kërkesës të vendimit të kontestuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
19. Më 18 maj dhe 4 qershor 2020, Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzuan përgjigjet e tyre në lidhje me kërkesën nr. KI15/19.
20. Përgjigjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë janë reflektuar në tekstin e mëposhtëm tek vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës.

21. Më 23 shtator 2020, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

22. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me burgim të përjetshëm nga gjykata penale në Basel-Zvicër me Aktgjykimin SG 2002/248 St/Sc/ste i datës 19.09.2002, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 26.09.2003, për shkak të veprës penale Vrasje dhe vrasje të shumëfishtë në tentativë, bazuar në nenin 112, nenin 68 (1), nenin 69 dhe nenin 55 alineja 1 të Kodit Penal të Zvicrës.
23. Me 25 shtator 2017, Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës kishte pranuar një shkresë nga Departamenti Federal për Drejtësi dhe Polici të Zvicrës, përmes së cilës është dhënë pëlqimi sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës (te dënuarit Shemsi Ferizi) për transferim nga Institucioni Korrektues në Zvicër në Institucionet Korrektuese në Republikën e Kosovës, për te vuajtur pjesën e mbetur të dënimit .
24. Konfederata Zvicerane-Departamenti Federal për Drejtësi dhe Polici i Zvicrës kishte dorëzuar dokumentet në vijim: (i) Vendim i plotfuqishëm i Gjykatës Penale Basel-Stadt, SG 2002/248 St/Sc/ste i datës 19.09.2002; (ii) Kërkesa për transferim me datë 31.03.2015 në Menzingen-Zvicër; (iii) Shkresa me datë 06.05.2015 nga Departamenti i Drejtësisë dhe Sigurisë së kantonit Basel-Stadt-Shërbimi për Qytetarë dhe Migracioni, Enti për Përmbarime Juridike Burgu; (iv) kopja e dispozitave ligjore të aplikuara; (v) ekstrakt i lindjes-përfshirë të dhënat mbi identitetin e të pandehurit (parashtruesit të kërkesës).
25. Më 20 dhjetor 2017, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës kishte paraqitur kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me transferimin e parashtruesit të kërkesës nga institucionet korrektuese të Zvicrës për në Institucionin Korrektues të Republikës së Kosovës.
26. Më 13 prill 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykim NJN.nr.157/2017) në çështjen e konvertimit të dënimit me burg të përjetshëm, shqiptuar nga Gjykata Penale Basel-Stadt (qyteti Basel) në Zvicër, me Aktgjykimin SG 2002/248 St/Sc/ste i datës 19.09.2002, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 26.09.2003, ndaj të dënuarit Shemsi Ferizi, për shkak të veprës penale Vrasje dhe vrasje të shumëfishtë në tentativë, bazuar në nenin 112, nenin 68 (1), nenin 69 dhe nenin 55 alineja 1 të Kodit Penal të Zvicrës, duke vendosur sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës në referim të shkresës nga Departamenti Federal për Drejtësi dhe Polici të Zvicrës, përmes së cilës është dhënë pëlqimi për transferim sipas kërkesës së të dënuarit Shemsi Ferizi për transferimin e tij nga Enti për përmbarime juridike-Zvicër, për në Institucionet Korrektuese në Republikën e Kosovës, në seancën e kolegjit të mbajtur në datë 13.04.2018, gjykoi: “Me

dënim unik me burgim të përjetshëm në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim që nga data 26.02.2001 e tutje”.

27. Aktgjykimi lartpërmendur i Gjykatës Themelore kishte përcaktuar: (i) se parashtruesi i kërkesës ka dhënë pëlqimin e tij për transferim dhe konvertim të dënimit nga autoritet zvicerane tek autoritet kosovare; (ii) transferimi dhe konvertimi i dënimit të parashtruesit të kërkesës është zbatuar në bazë të nenit 65 të Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale; dhe, (iii) se ekziston Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi transferimin e personave të dënuar.
28. Në fund, Gjykata Themelore kishte përcaktuar se: *“Bazuar në nenin 63 par.2 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet Penale Nr.04/L-213, kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesë”.*
29. Më 18 maj 2018 Ministria e Drejtësisë iu drejtua Departamentit Federal të Drejtësisë dhe Policisë të Konfederatës Zvicerane me Kërkese për Transferim [Ref. MD/DBGJ/2086/fg/18; DBNJ/2014/1377] ku konfirmoi vendimin për lejimin e transferimit të parashtruesit të kërkesës duke qenë se ishin plotësuar të gjitha kushtet sipas marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Konfederatës Zvicerane dhe Republikës së Kosovës për bashkëpunim në çështjet penale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 2 të Protokollit Nr. 7 (E drejta e apelit në çështjet penale) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të neneve 8 dhe 11 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e dt. 04.11.1950, ndryshuar me Protokollin nr.11 dhe nr 14 në nenin 6 parashihet të drejtat për një proces të rregullt, ku paragrafi 1 parasheh përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të tije civile ose të çdo akuze penale kundër tije, çdo person ka të drejtë që çështja e tije të dëgjohet drejtësisht, çka në rastin konkret nuk iu është mundësuar të pandehurit Shemsi si i pandehur të dëgjohet fare nga Gjykata Themelore në Prishtinë.”.*
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Protokollin 7 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ndryshuar me Protokollin numër 11 Strasburg, 22.11.1984, në nenin 2 parasheh të Drejtën e Apelit në Çështjet Penale. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqet për shqyrtim para një gjykatë me të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte duhet përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligje”.*

33. Për sa i përket garancive nga nenet 8 dhe 11 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, parashtrues i kërkesës pretendon: “*Ne deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (dt 10.12.1948), ne nenin 8 parasheh se secili ka të drejte qe me mjete juridikë efektive para gjykatës kompetente kombëtare të mbrohet nga veprimet e shkeljes se të drejtave themelore të Garantuara me Kushtetutë e me Ligje. Për të vazhduar me pastaj ne nenin 11, e nuk duhet të jepet dënim me i rende se aj qe ka mundur të zbatohet ne kohen kur është kryer vepra penale. Çka nuk është vepruar kështu ne rastin konkret, meqenëse vepra penale është kryer me 26.02.2001, kur ka qene ne fuqi Ligji Penal KSAK-se, ndërsa me aktgjykimin e atakuar, është zbatuar kodi penal i RS, i cili është ma i disfavoreshem për të pandehurin Shemsi”.*
34. Për sa i përket zbatimit të ligjit të pafavorshëm, parashtruesi i kërkesës pretendon: “*Ligji penal i KSAK-se, i cili ishte ne fuqi ne kohen e kryerjes se veprës penale, për veprën penale vrasje e rende, kishte parapare dënim jo me pak se 10 vite ose dënim me vdekje, por se meqë dënimi me vdekje është i ndaluar ne baze të dispozitës së nenit 25 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për të vazhduar me pastaj se me dispozitën e nenit 22 të Kushtetutës, parashihtet zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve ndërkombëtare. Ashtu që, sipas kësaj dispozite, dispozitat e me lartcekura të Konventave dhe Protokolleve ndërkombëtare zbatohen drejtpërsëdrejti ne Republikën e Kosovës, e të cilat ne rastin konkret janë shkelur nga Gjykata Themelore ne Prishtine, me aktgjykimin NJN.nr.157/17”.*
35. Përfundimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata: “*Me kërkesën tonë kërkojmë, qe të konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine NJN.nr.157/17 i dt 13.04.2018 është marur me shkelje flagrante të të drejtave të garantuara të të pandehurit Shemsi Ferizi nga fsh Vernice, KK Mitrovicës, meqë nuk i'u është mundësuar të jepen mbrojtjen e tij, se i'u është mohuar e drejta ne ankese ndaj këtij aktgjykimi dhe se gjykata ka aplikuar ligjin i cili nuk ka qene ne fuqi ne kohen e kryerjes se veprës penale, e cili ligj është shume ma i disfavoreshm se ligji i kohës kur është kryer vepra penale, i cili atëherë nuk kishte parapare llojin e dënimit burg të përjetshëm”.*

Dispozitat relevante ligjore

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 04/L-082

Neni 44

Dënimi me burgim të përjetshëm

- 1. Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda.*

2. Ligji nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një vepër të veçantë penale.

3. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetënjë (21) vjet ose personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore.

Neni 45
Dënimi me burgim

1. Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se tridhjetë (30) ditë e as më tepër se njëzet e pesë (25) vjet.

2. Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe në muaj të plotë, e në rastet kur dënimi është deri në gjashtë (6) muaj, dënimi shqiptohet në ditë të plota.

LIGJI PENAL I KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS (Nr. 011-25/17, 28 qershor 1977)

Vrasja
Neni 30

[...]

(2) Me burgim jo më pak se dhjetë vjet ose me dënim me vdekje do të dënohet:

1) Kush tjetrin në mënyrë mizore ose dinake e privon nga jeta;

2) Kush tjetrin e privon nga jeta dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën edhe të një personi tjetër.

LIGJI PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE
NR. 04/L-213

Neni 62

Qëllimi dhe kushtet për transferim

1. Ministria mund të lejoj transferimin e personit të dënuar nga shteti tjetër, në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës me qëllim të vuajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit, me kusht që vepra penale për kryerjen e të cilës personi është dënuar në shtetin dënues është vepër penale edhe në bazë të ligjit vendor.

2. Transferi mund të lejohet në bazë të kërkesës në të shkruar së paraqitur tek Ministria nga shteti dënues apo personi i dënuar ose nga një person i autorizuar nga ai apo ajo, nëse shteti dënues jep pëlqimin për transfer.

Neni 63

Procedura e Ekzekutimit

1. Personat që transferohen në bazë të këtij ligji i nënshtrohen njëres nga procedurave të e mëposhtme:

1.1. vazhdimit të ekzekutimit dënimit, kur shteti dënues është shtet anëtar i Bashkimit European, apo shtet me të cilin Republika e Kosovës ka marrëveshje ndërkombëtare me të cilat parasheh vazhdimin e dënimit;

1.2. konvertimit të dënimit, kur shteti dënues është shtet tjetër nga ata të përmendur në paragrafin 1.1. të këtij neni.

2. Gjykata Themelore e Prishtinës është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e përmendur sipas paragrafit 1. të këtij neni. Vendimet nuk mund të ankimohen.

Neni 64

Vazhdimi i ekzekutimit të dënimit

1. Në rastet e referuara në paragrafin 1.1. të nenit 63 të këtij ligji, gjykata kompetente do të lëshoj vendim me të cilin vazhdon ekzekutimin e dënimit të shqiptuar në Shtetin dënues. Gjykata është e detyruar t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit të shqiptuar në Shtetin dënues.

2. Në rast se dënimi i shqiptuar në Shtetin dënues, për nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin vendor, dënimi duhet të konvertohet në përputhje me nenin 65 të këtij ligji.

Neni 65

Konvertimi i Dënimit

1. Në rastet e referuara në paragrafin 1.2. të nenit 63 të këtij ligji, gjykata kompetente lëshon vendim me të cilin shqipton dënim në pajtim me ligjin vendor.

2. Gjykata gjatë konvertimit të dënimit duhet:

2.1. t'i përmbahet gjetjeve të paraqitura në gjykimin e shqiptuar nga shteti dënues;

2.2. të mos konvertojë dënimin me burgim në dënim me gjobë;

2.3. të llogaris në dënimin final kohën e mbajtur të dënimit në shtetin dënues nga personi i dënuar, dhe

2.4. të mos rëndoj statusin penal të personit të dënuar dhe nuk është e lidhur me dënimin minimal të përcaktuar për atë vepër penale me ligjin e shtetit dënues.

3. Procedura e konvertimit duhet të përfundojë para transferimit të personit të dënuar.

MARRËVESHJE NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KONFEDERATËS ZVICERANE MBI TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR (Dekret Nr. DMN-004-2012, 01 qershor 2012)

Neni 12 Efekti i transferimit për shtetin dënues

1. Autoritetet kompetente të shtetit administrues:

a) në rastin e Republikës së Kosovës do ta konvertojnë dënimin përmes procedurës gjyqësore apo administrative me një vendim të atij shteti duke e zëvendësuar me dënimin e shqiptuar në Konfederatën Zvicerane me një denim të paraparë me një ligj të Republikës së Kosovës për të njëjtën veprë penale, në bazë të kushteve të parapara në Nenin 13 paragrafi 1.

[...]

2. Zbatimi i dënimit do të rregullohet me ligjin e shtetit administrues dhe vetëm ai shtet është kompetent për marrjen e vendimeve të duhura.

Neni 13 Vazhdimi i zbatimit dhe konvertimi i dënimit

1. Në rast të konvertimit të dënimit në pajtim me Nenin 12, paragrafi 1, shkronja a, do të aplikohen procedurat e parapara me ligjin e Republikës së Kosovës. Gjatë konvertimit të dënimit, autoriteti kompetent:

- a) U detyrohet konstatimeve faktike, përveç nëse ato rrjedhin nga një urdhëresë e nxjerrë nga aktgjykimi i shqiptuar në Konfederatën Zvicerane;
- b) nuk guxon ta konvertojë dënimin me privim lirie ma një denim me një gjobë;
- c) do ta zbresë periudhën e plotë të privimit të lirisë që është vuajtur nga personi i dënuar; dhe
- d) nuk guxon ta vështirësojë pozitën penale të personit të dënuar dhe nuk i detyrohet asnjë minimumi, të cilin ligji i Republikës së Kosovës e parasheh për veprën ose veprat e kryera penale.

2. Në rast të vazhdimit të zbatimit në pajtim me nenin 12, paragrafin 1. Shkronja b, Konfederata Zvicerane lidhet me natyrën juridike dhe kohëzgjatjen e dënimit, siç është përcaktuar në Republikën e Kosovës. Nëse megjithatë ky dënim për kah natyra ose kohëzgjatja e tij është në papajtueshmëri me ligjin e Konfederatës Zvicerane, Konfederata Zvicerane përmes një urdhërese të gjykatës ose urdhëresës administrative mund ta adaptojë dënimin ose masën për veprë të ngjashme penale e paraparë me ligjin e saj. Sa i përket natyrës së tij, dënimi ose masa duhet për aq sa është e mundur të korrespondojë me atë që është shqiptuar në dënimin që do të zbatohet. Ai nuk guxon ta vështirësojë, qoftë për shkak të natyrës, ose kohëzgjatjes, sanksionin e shqiptuar në Republikën e Kosovës, e as të tejkalojë maksimumin e paraparë me ligjin e Konfederatës Zvicerane.

3. Para transferimit shteti administrues ia dorëzon shtetit dënues vendimin me përmbajtjen e dënimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

38. Gjykata po ashtu u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

*Neni 47
[Kërkesa individuale]*

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj”.

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

*Neni 49
[Afatet]*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

39. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (c) (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranueshëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën”

40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se ekziston një vendim që përcakton të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës: (i) Aktgjykimi SG 2002/248 St/Sc/ste i Gjykatës penale Basel-Stadt në Zvicër, i 19 shtatorit 2002, që kishte shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm ndaj parashtruesit të kërkesës; dhe, (ii) Aktgjykimi e Gjykatës Themelore në Prishtinë [NJN.nr.157/2017] të 13 prillit 2018, që nuk përcakton të drejtat dhe detyrimet civile dhe as përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës, por që mundëson konvertimin e më pas transferimin, dhe vuajtjen e dënimit në Institucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ngre ndonjë pretendim kundër veprimeve të autoriteteve zvicerane.
41. Sa i përket vërtetimit të afatit për dorëzim të kërkesës siç parashikohet me nenin 49 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [NJN.nr.157/2017] të 13 prillit 2018, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit pranë kësaj gjykate është dorëzuar më 22 janar 2019, ndërsa për Gjykatën është e panjohur data se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [NJN.nr.157/2017] i 13 prillit 2018.
42. Në këtë drejtim, Gjykata ka kërkuar dëshmi (fletë-kthesë) që tregon datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga vetë përfaqësuesi i parashtruesit, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Ministria e Drejtësisë. Asnjëri nga palët e përfshira në këtë procedurë nuk kishte arritur që të siguronte dëshminë (fletë-kthesën) që vërteton datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës apo përfaqësuesi i tij.
43. Në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë më 22 gusht 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës kishte deklaruar: *“Aktgjykimin NIN.nr.157/2017 të datës 13.04.2018, në lidhje me transferimin e të dënuarit Shemsi Ferizi kjo gjykatë ia ka përcjell dhe dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë me datë 20.04.2018 [...]Ministria e Drejtësisë pas pranimit të vendimit të gjykatës e cila sipas ligjit vendimin e saj e nxjerr para transferimit të personit të dënuar, vendos për aprovimin apo jo të transferimit, kështu që për ecurinë-procedurat e mëtutjeshme pas dorëzimit të vendimit në MD duke përfshirë edhe dorëzimin e vendimit parashtruesit, është kompetencë që të vendosin autoritet tjera e jo*

gjkata e cila ka nxjerr vendimin, në rastin konkret Gjykata Themelore në Prishtinë”.

44. Në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë më 5 shtator 2019, Ministria e Drejtësisë kishte deklaruar: *“Ju lutem vëreni se meqenëse kemi të bëjmë me një kërkesë të Gjykatës, dhe fletë-kthesë dhe Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ju lutemi që të njëjtën tja adresoni Gjykatës së lartcekur, si organ që ka bërë lëshimin e Aktgjykimit”.*
45. Në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë më 30 gusht 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, kishte deklaruar: *“Njoftoheni se nuk jemi ne gjendje ta përmbushmi kërkesën juaj, nga fakti se Gjykata Themelore ne Prishtine, aktgjykimin e permendur nuk i'a ka dërguar asnjëherë parashtruesit te kërkesës Shemsi Ferizi, meqenëse se i njëjti ne atë kohe ka qene ne vuajtje te dënimit ne Institucionet Ndëshkimore Zvicerane, porse ky aktgjykim i'u ishte dorëzuar organeve kompetente Zvicerane, me qellim qe parashtruesi Shemsi Ferizi te ekstradohet ne Kosove”.*
46. Ndaj kërkesës të përsëritur të Gjykatës të 15 majit 2020 lidhur me datën e pranimit të aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës, Ministria e Drejtësisë në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë më 18 maj 2020, mes tjerash, kishte theksuar: *“Ju lutem vëreni se, Ministria e Drejtësisë si autoritet qendror për ndihmë juridike ndërkombëtare, pa dashur të thellohet në interpretim të rastit, me mirësi ju njoftojmë se vendimi i gjykatës mbi transferimin e personit të dënuar dhe konvertim të dënimit sipas Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, neni 65, paragrafi 3, merret para transferimit të personit të dënuar dhe është një procedurë e përshtatjes së dënimit sipas gjetjeve dhe vendimit të shqiptuar nga autoritetet e shtetit dënues. Po ashtu, sipas nenit 63, paragrafi 2 i ligjit të sipërcituar vendimi nuk mund të ankimohet. Po ashtu, ju informojmë se sipas Marrëveshjes dypalëshe në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi transferimin e personave të dënuar, respektivisht neni 16, vetëm shteti dënues ka të drejtë ekskluzive për të vendosur mbi çdo kërkesë për shqyrtimin e vendimit”.*
47. Ndaj kërkesës të përsëritur të Gjykatës të 15 majit 2020 lidhur me datën e pranimit të aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Themelore në përgjigjen e dorëzuar në Gjykatë më 4 qershor 2020 përsëriti se aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë më 20 prill 2018. Në përgjigjen e dorëzuar, Gjykata Themelore kishte bashkangjitur edhe fletë-kthesën që vërteton se aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë në datën e lartpërmendur. Gjykata Themelore ritheksoi: *“...pas dorëzimit të vendimit në MD duke përfshirë edhe dorëzimin e vendimit të parashtruesit, është kompetencë që të vendosin autoritetet tjera e jo gjykata e cila e ka nxjerrë vendimin, në rastin konkret Gjykata Themelore në Prishtinë”.*
48. Gjykata vëren se nëse datat 13 prill 2018 kur me Aktgjykimin e kontestuar u vendos për konvertimin e dënimit me burg të përjetshëm, por edhe data 20 prill 2018 kur Gjykata Themelore i kishte dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë

aktgjykimin e kontestuar bashkangjitur edhe fletë-kthesën që vërteton se aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë llogariten si datat kur fillon të rrjedhë afati ligjor katër (4) mujour, atëherë, rezulton se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë pas afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit. Megjithatë, duke pasur parasysh përgjigjet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se parashtruesit të kërkesës nuk mund t'i vihet një barrë jo-proporcionale për të provuar se kërkesa e tij është brenda afatit ligjor. Natyra e rastit dhe fakti se nuk lejohet ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e obligojnë Gjykatën që t'i shmanget formalizmit të skajshëm sepse interpretimi veçanërisht i rreptë i një rregulli procedural mund të ngre çështje të qasjes në drejtësi (shih, mutatis mutandis, rastin e GJEDNJ-së, *Perez de Rada kundër Spanjës*, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 49).

49. Në rastin e lartpërmendur *Perez de Rada kundër Spanjës*, GJEDNJ-ja kishte theksuar se roli i saj kufizohet në konstatimin nëse efektet e interpretimit të së drejtës vendore janë të pajtueshme me KEDNJ-në. Kjo është e vlefshme posaçërisht për interpretimin nga gjykatat të dispozitave të natyrës procedurale siç janë afatet ligjore që rregullojnë dorëzimin e dokumenteve dhe paraqitjen e ankesave. GJEDNJ-ja kishte theksuar se rregullat për afatet e paraqitjes së ankesës pa mëdyshje janë të dizajnuara për të siguruar administrimin e drejtë të drejtësisë dhe pajtueshmërinë, në veçanti, me parimin e sigurisë juridike. Megjithatë, këto rregulla ose zbatimi i tyre, nuk duhet t'i pengojnë ndërgjyqësit në përdorimin e një mjeti në dispozicion. Në rastin *Perez de Rada*, GJEDNJ-ja vërejti se parashtruesja kishte qëllim të qartë që të ankohej në gjykatën e apelit (*Audiencia Provincial*) kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë (*Aoiz Court of first instance*) që e kishte anuluar një marrëveshje të lidhur ndërmjet parashtrueses dhe fqinjit të saj. Parashtruesja ishte përpjekur pa sukses që ankesën kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ta dorëzojë përmes gjykatës kujdestare në Madrid (*Madrid duty court*), mirëpo duke e parë se ankesa është dashur t'i adresohet gjykatës së shkallës së parë (*Aoiz Court of first instance*), shefi i shkrimoreve (*the head of the registry office*) i gjykatës kujdestare kishte hequr vulën nga ankesa duke e bërë atë të pavlefshme. Parashtruesja po ashtu ishte përpjekur pa sukses që ta dorëzon ankesën në gjykatën e shkallës së parë (*Aoiz Court of first instance*) me qëllim të anulimit të vendimit të së njëjtës gjykatë, me ç' rast, duke e shpallur ankesën të papranueshme si të paafatshme, kishte penguar çfarëdo ankesë në gjykatën e apelit (*Audiencia Provincial*). GJEDNJ-ja vlerësoi se të obligohet parashtruesja të udhëtojë në Aoiz në mënyrë që ta dorëzojë ankesën brenda afatit ligjor, derisa vendimi i kontestuar asaj i ishte dorëzuar në Madrid, në rastin konkret, është e paarsyeshme. GJEDNJ-ja konstatoi se interpretimi veçanërisht i rreptë i rregullave procedurale lidhur me afatet ligjore nga gjykatat vendore i kishte mohuar parashtrueses të drejtën për qasje në gjykatë të garantuar me nenin 6 (1) të KEDNJ-së (shih *Perez de Rada*, cituar më lart, paragrafët 43-50).
50. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë nëse Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [NJN.nr.157/2017] i 13 prillit 2018, në ndonjë mënyrë, ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës.

51. Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
52. Sa i përket vendimeve të autoriteteve kosovare për konvertim, transferim, dhe vuajtje të dënimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se edhe ato procedura potencialisht mund të ngrenë çështje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që GJEDNJ-ja i ka shqyrtuar në kuadër të nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së e në disa raste ajo është vënë vetë në lëvizje (*own motion*) për të shqyrtuar nëse nenet 6 (E drejta për proces të rregullt) dhe 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së janë të zbatueshme ndaj procedurave në fjalë (shih, *mutatis mutandis*, *Vermae kundër Finlandës* (vendim), nr. 38704/03, 15 mars 2005; *Janos Csozanski kundër Suedisë* (vendim), nr. 22318/02, 26 tetorit 2004 dhe Çështjen *Groni kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, ankesë nr. 25336/04, Aktgjykim i 7 korrikut 2009, paragrafët 134-162 dhe referencat e përmendura aty).
53. Gjykata duke u mbështetur në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së, në parim, duhet të vlerësojë nëse procedura e konvertimit, transferimit, dhe vuajtjes së dënimit të parashtruesit të kërkesës është zbatuar në pajtim me dispozitat ligjore të qarta dhe të qasshme nga e drejta vendore dhe ndërkombëtare (shih, *Groni kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafët 134-162).
54. Gjykata vëren se në rastin e lartpërmendur Groni kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja kishte konstatuar shkelje të nenit 5 (1) të KEDNJ-së në dëm të ankuesit duke u bazuar në testin si vijon: (i) nëse ankuesi ishte transferuar për vuajtje të dënimit nga autoritetet italiane tek autoritetet shqiptare me pëlqimin e tij, siç parashikonte ligji procedural penal; (ii) nëse transferimi dhe konvertimi i dënimit të ankuesit kishte bazë ligjore vendore dhe (iii) ishte i bazuar në marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe për bashkëpunim në çështjet penale midis Shqipërisë dhe Italisë.
55. Në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse konvertimi i dënimit, dhe transferimi i parashtruesit të kërkesës nga autoritetet zvicerane tek autoritetet kosovare, i bën ballë testit të GJEDNJ-së të përdorur në rastin Groni kundër Shqipërisë.
56. Për sa i përket (i) dhënies së pëlqimit të parashtruesit të kërkesës për transferim tek Institucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi lartpërmendur i Gjykatës Themelore përcakton: "*I dënuari Shemsi Ferizi, transferimi i të cilit kërkohet është shtetas i Republikës së Kosovës, i cili ka dhënë pëlqimin për transferim përkatësisht për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në Institucionet Korrektuese në Republikën e Kosovës, vendimi me të cilën i është shqiptuar dënimi është i formës së prerë, Vepra penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar parashihet si vepër penale edhe me KPK dhe atë Vepër Penale Vrasje e Rëndë të parashikuar me nenin 179 par 1 pika 8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të vrasjes me paramendim në tentativë nga neni 28 par. 1. [...] Dhënia e pëlqimit nga i*

pandehuri për transferimin përkatësisht për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në Institucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës, rezulton nga referenca MDIDBGJ/3937/17 DBJN/2009-00345 me datë 01.11.2017 e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës”.

57. Për sa i përket (ii) bazës ligjore për konvertimin e dënimit të parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi lartpërmendur i Gjykatës Themelore përcakton: *“Nga arsyet e përmendura më lartë, kjo gjykatë bëri konvertimin e dënimit në mbështetje të nenit 65 të Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe njëherit konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me Marrëveshjen Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi transferimin e Personave të dënuar, dhe nuk janë prezentë faktet e parapara të cilat do të paraqesin pengesë lidhur me ekzekutimin apo transferimin e ekzekutimit”.*
58. Për sa i përket (iii) bazës ligjore për transferim të parashtruesit të kërkesës-Marreveshjes Nderkombtare per transferim tek Institucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi lartpërmendur i Gjykatës Themelore përcakton: *“Kolegji Shqyrtues i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të kërkesës për transferimin e të dënuarit dhe dokumenteve tjera shoqëruese, si dhe pas vlerësimit të të njëjtave, mbështetur në Marrëveshjen mbi transferimin e personave të dënuar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane si dhe në Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ose Çështjet Penale Nr.04/L-213, konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore te parapara për lejimin e transferimit te dënuarit Shemsi Ferizi për në Institucionin Korrektues të Republikës së Kosovës”.*
59. Për sa i përket llogaritjes së kohës të kaluar në paraburgim nga parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Themelore përcakton: *“[...] dënim unik me burgim të përjetshëm në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim që nga data 26.02.2001 e tutje”.*
60. Nga sa më sipër, Gjykata përfundon se konvertimi i dënimit dhe transferimi i parashtruesit të kërkesës është zbatuar në pajtim me testin e GJEDNJ-së të përdorur në rastin Grori kundër Shqipërisë, sepse: (i) parashtruesi ka dhënë pëlqimin e tij për transferim dhe konvertim të dënimit; dhe (ii) transferimi dhe konvertimi i dënimit të parashtruesit të kërkesës është zbatuar në bazë të nenit 65 të Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale; dhe, (iii) Marrëveshjen Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi transferimin e personave të dënuar.
61. Prandaj, nuk mund të thuhet se procedura e transferimit dhe konvertimit të dënimit, në një masë të arsyeshme në raport me rrethanat e rastit, nuk ka qenë e parashikueshme për parashtruesin e kërkesës apo se konvertimi i dënimit nuk është bazuar në procedurë të parashikuar me ligj (shih, anasjelltas, *Grori kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafi 161).

62. Gjykata rikujton edhe njëherë se parashtruesi pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë NJN. Nr. 157/2017, i 13 prillit 2018, i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 dhe nenin 2 të Protokollit Nr. 7 (E drejta e apelit në çështjet penale) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të neneve 8 dhe 11 të DUDNJ-së.
63. Paragrafi 2 i nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës përcakton: “2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.
64. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës përcakton: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.
65. Paragrafi 1 i nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së përcakton: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.
66. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se gjykata themelore gjatë procedurës së konvertimit të dënimit nuk ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet civile dhe as bazueshmërinë e akuzës penale në ngarkim të parashtruesit të kërkesës veçse iu është përmbajtur konstatimeve të paraqitura nga shteti dënues (shih neni 65 i Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale Nr. 04/L-213). Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, procedurat lidhur me ekzekutimin e dënimit nuk mbulohen nga neni 6 i KEDNJ-së (shih, mutatis mutandis, *Aydin kundër Turqisë* (vendim), nr. 41954/98, 14 shtator 2000).
67. Rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
68. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së, nenin 2 të Protokollit Nr. 7 [E drejta e apelit në çështjet penale] të KEDNJ-së dhe nenin 8 [pa titull] të DUDNJ-së, Gjykata vëren se vetëm shteti dënues ka të drejtë të vendosë mbi aplikimin e rishqyrtimit të aktgjykimit (shih neni 16 [Rishqyrtimi i aktgjykimit] të

Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi Transferimin e Personave të Dënuar) dhe se Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencë lidhur me procedurën e ekzekutimit të dënimit dhe se vendimi i saj nuk mund të ankimohet (shih nenin 63 [Procedura e Ekzekutimit] të Ligjit Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Megjithatë, Gjykata vlerëson se parashtruesit nuk i është cenuar e drejta në ankesë sepse atij i është mundësuar dhe në të vërtetë ka dorëzuar kërkesë kushtetuese në këtë Gjykatë, që është autoritet kompetent për të vlerësuar substancën e ankesave të parashtruesit të kërkesës. E drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për një mjet efektive juridik nuk ofron garanci për rezultat të favorshëm për parashtruesin e kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-së *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 157). Mjeti efektiv juridik në kontekst të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, nuk nënkupton një mjet të suksesshëm juridik, por thjesht një mjet të qasshëm para një autoriteti kompetent për vlerësim në substancë të ankesave të parashtruesit të kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-së, *C kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i vitit 1983).

69. Rrjedhimisht pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, nenin 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe nenin 8 të DUDNJ-së, duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.
70. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij nuk është zbatuar ligji më i favorshëm për sa i përket kohës së kryerjes së veprës penale. Ai pretendon se në rastin e tij është dashur të zbatohet ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm, KSAK) në vend të ligjit penal në fuqi në Republikën e Kosovës.
71. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se pretendimi për zbatim të ligjit më të favorshëm, në substancë, ngre çështje nga neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës lidhur me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së dhe nenin 11 [Pa titull] të DUDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata do ta shqyrtojë këtë pretendim në kuadër të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së dhe nenin 11 të DUDNJ-së (shih, mutatis mutandis, *Vermae kundër Finlandës* dhe *Janos Csozanski kundër Suedisë*, cituar më lart).
72. Paragrafi 3 i nenit 33 të Kushtetutës përcakton: “3. Dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës”.
73. Paragrafi 1 i nenit 7 të KEDNJ-së përcakton: “1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte veprë penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale”.
74. Paragrafi 2 i nenit 11 të DUDNJ-së përcakton: “2. Askush nuk do të shpallet fajtor për ndonjë veprë penale lidhur me ndonjë veprim apo mos veprim që nuk përbën veprë penale, bazuar në të drejtën vendore dhe ndërkombëtare,

në kohën kur është kryer. Po ashtu nuk do të shqiptohet dënim më i rëndë se sa dënimi që ka qenë i zbatueshëm në kohën kur është kryer vepra penale”.

75. Për sa i përket pretendimit për zbatim të ligjit më të favorshëm përkatësisht ligjit penal të KSAK, Gjykata vëren se në rastin e parashtruesit bazuar në nenin 12.1 a) të Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi Transferimin e Personave të Dënuar, parashihet që autoritetet kosovare do ta konvertojnë dënimin përmes procedurës gjyqësore ose administrative me një vendim të atij shteti duke e zëvendësuar dënimin e shqiptuar në Konfederatën Zvicerane me një dënim të paraparë me ligjin e Republikës së Kosovës për të njëjtën vepër penale.
76. Gjykata ka parasysh se zbatimi i ligjit penal në fuqi në Republikën e Kosovës në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk mund të karakterizohet si përcaktues i bazueshmërisë së akuzës penale apo dënim i ri në kuptim të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së (shih, mutatis mutandis, *Janos Csozanski kundër Suedisë*, cituar më lart). Veç kësaj, nuk ekziston ndonjë e drejtë sipas Kushtetutës apo KEDNJ-së për vuajtje të dënimit me burg në pajtim me një regjim të caktuar të dënimeve (shih, mutatis mutandis, *János Csozanszki kundër Suedisë* dhe *Aydin kundër Turqisë*, cituar më lart).
77. Megjithatë, Gjykata vëren se neni 30 (2) 1) i ligjit penal të KSAK në të cilin thirret parashtruesi parashikonte se për veprën penale të vrasjes mund të shqiptohej dënim me burg prej jo më pak se dhjetë vjet ose me dënim me vdekje. Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se ligji i KSAK është më i favorshëm në rastin e tij, është pretendim qartazi i pabazuar duke pas parasysh se për veprën në fjalë parashihej edhe dënim me vdekje .
78. Nga sa u tha më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë se ka bazë thelbësore (*substantial grounds*) për të besuar se zbatimi i ligjit penal në fuqi në Republikën e Kosovës në vend të ligjit penal të KSAK është në mënyrë flagrante jo-proporcional, apo se përgjithësisht është jo –proporcional (shih, mutatis mutandis, *Vermae kundër Finlandës*, cituar më lart).
79. Rrjedhimisht, pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së dhe nenin 11 të DUDNJ-së, duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.
80. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese, duhet të refuzohet e papranueshme siç përcakton neni 113 (7) i Kushtetutës, parashikojnë nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 39 (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe (3) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi